



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo Finasija – Ministry of Finance



Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs
Sektori i Origjinës

Qeveria e Republikës së Kosovës, duke u mbështetur në kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore, përmes *Vendimit Nr. 13/265, datë 01.08.2025*, ka miratuar masa të njëanshme për heqjen e tarifës doganore mbi mallrat me origjinë preferenciale nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Vendimi si më lartë synon vendosjen e normës doganore zero për mallrat e importuara nga SHBA, duke u mbështetur në *Ligjin Nr. 04/L-163 dhe në Kodin Doganor dhe të Akcizave Nr. 08/L-247*.

Në përputhje me këtë legjislacion, mallrat që plotësojnë kriteret e origjinës preferenciale nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe publikimit të tij në *Gazetën Zyrtare* më 01.08.2025, mund të importohen në territorin doganor të Republikës së Kosovës pa pagesë të tarifës doganore.

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel & Fax (++ 381 38) 540 350 /540 836
www.dogana-ks.org

Për të përfituar nga trajtimi preferencial, mallrat e importit duhet të jenë në përputhje me *Rregullat e Origjinës* në përputhje me legjislacionin doganor të të dyja vendeve.

Origjina e mallrave mund të dëshmohet përmes dokumentacionit përkatës:

CERTIFIKATË E ORIGJINES lëshuar nga Dhomat Amerikane të Tregtisë në original, të autorizuar ligjrisht për lëshimin e ketyre certifikatave, dhe

Dokumentet percjellese të mallrave janë si në vijim:

- Dokumente të lëshuara nga kompanitë eksportuese (fatura tregtare, fletë-dërgesa, etj.).
- Dokumentet e transportit të mallrave.

OSE

DEKLARATA E EKSPORTUESIT TË MIRATUAR (Approved Exporter)

Origjina e mallrave mund të dëshmohet gjithashtu përmes deklaratës së eksportuesit të miratuar, ose deklarim ekuivalent i lëshuar në përputhje me legjislacionin doganor të SHBA-së:

- Eksportuesi duhet të jetë i regjistruar dhe i autorizuar nga autoritetet doganore të SHBA-së (CBP).
- Deklarata duhet të përmbajë numrin e regjistrimit të eksportuesit të miratuar dhe të deklarojë se mallrat përmbushin kriteret e origjinës preferenciale.

Prishtinë, 04.03.2026